



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RrGGK dënon aktet e dhunës në Pejë dhe Prizren, si dhe kërkon që të dyshuarit për kryerjen e veprave të vihen para drejtësisë

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) nga një [artikull](#) i ditës së sotme në gazetën Zëri dhe në portalin Fax.al u njoftua për dy raste të dhunës në familje në dy komuna të ndryshme të Kosovës.

Rasti i parë kishte ndodhur mes një çifti të martuar nga Komuna e Prizrenit, ku pas intervenimit të policisë, i dyshuari me vendim të prokurorit është dënuar me mbajtje.

Ndërsa, rasti i dytë kishte ndodhur në fshatin Pavlan të Komunës së Pejës, ku poashtu u sulmua fizikisht një grua nga bashkëshorti dhe vjehri i saj, me ç'rast me vendim të prokurorit janë liruar të dy me procedurë të rregullt.

RrGGK dënon rëndë aktin e sulmit fizik ndaj të dyja grave në fjalë. Në anën tjetër, RrGGK shpreson se prokuroria në Komunën e Pejës do ta bëjë siç duhet punën në mbledhjen e fakteve dhe të ngritë aktakuzë ndaj të dyshuarve të kryerjes së kësaj vepre, dhe se brenda afatit të caktuar ligjorë të dyshuarit do të përgjigjen për veprën e tyre.

RrGGK shpreson që këto dy gra kanë pranuar trajtimin e duhur nga insitucionet përgjegjëse, dhe ato tashmë janë në një vend të sigurtë, largë personave që ushtruan dhunë ndaj tyre.

RrGGK dënon rëndë çdo akt që cenon mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, e veçanërisht rastet e dhunës në familje, ku sipas raportit të fundit të RrGGK-së: [Mjaft më me arsyetime - Një analizë e qëndrimeve, incidencës dhe përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë](#), është vërejtur se dhuna në familje është ende prezente në shoqërinë kosovare, dhe gratë dhe vajzat janë kryesisht viktimat e kësaj dhune.

PRISHTINA

www.womensnetwork.org • Rr. Hajrullah Abdullahu Nr 25 10000

Prishtinë, Kosovë • +381 (0) 38 245 850 •

info@womensnetwork.org